



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
SP-031
Prishtinë, më 17, 30 maj dhe 1, 4 e 5 qershor 2018

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 17, 30 MAJ DHE 1, 4 E 5 QERSHOR 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetarët e Kuvendit, Xhavit Halit, Kujtim Shala dhe Aida Dërguti.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2018.

Në fillim, Kuvendi mbajti një minutë heshtje për vdekjen e ish-deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kujtim Paçaku.

Pastaj, kryetari procedoi me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Hykmete Bajrami, Nait Hasani, Albulena Haxhiu, Faton Topalli, Time Kadrijaj, Enver Hot dhe Islam Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Avdullah Hoti i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, në lidhje me shqetësimet e Kryetarit të Bashkësisë Lokale të fshatit Karaçevë e Ulët, Komuna e Kamenicës për hyrjen e Policisë serbe në atë fshat.

Ministri Bejtush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Ganimete Musliu i parashtrroi pyetje ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në lidhje pagesat për hyrje në Parkun Nacional të Brezovicës.

Ministrja Albena Reshitaj nuk ishte e pranishme në seancë.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me veprimet e ndërmarra nga Ministria e Shëndetësisë që institucionet shëndetësore publike të lëshojnë certifikatat mjekësore për kandidatët për patentë shofer.

Ministri Uran Ismaili iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me mbikëqyrjen e Komisionit ndërmintor për përcaktimin e shkallës së invaliditetit të invalidëve të luftës.

Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Haxhi Shala i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me përfshirjen e çështjeve të të drejtave të punëtorëve, përmirësimit të kushteve dhe sigurisë në punë në Strategjinë Sektoriale të kësaj ministrie.

Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Albulena Balaj-Halimaj i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me zhvillimin e politikave nga kjo ministri për përfshirjen më të madhe në punësim të të rinjve dhe grave.

Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Arbërie Nagavci i parashtrroi pyetje ministrit të Financave, Bedri Hamza, në lidhje me planifikimet buxhetore të kësaj ministrie në procesin e rishikimit të buxhetit për vitin 2018, për pagat jubilarë të mësimdhënësve të pensionuar.

Ministri Bedri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Enver Hoti i parashtrroi pyetje ministrit të Financave, Bedri Hamza, në lidhje me transferimin e inspektorëve komunalë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Ministri Bedri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Arbër Rexhaj i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, në lidhje me ekzistimin e seksioneve të ndara në Burgun e Dubravës dhe burgjet tjera për të burgosurit nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri, në lidhje me mos nxjerrjen e aktit nënligjor për zbatim të nenit 221 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Ministri Abelard Tahiri iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Salih Zyba i parashtrroi pyetje ministrit të Financave, Bedri Hamza, në lidhje me raportimet nga mediat se inspektorët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në Komunën e Mitrovicës Veriore marrin paga pa punuar.

Ministri Bedri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Sami Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri, në lidhje me informatat e kësaj ministrie për kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prizren drejtuar Qendrës së Mjekësisë Ligjore në Lozanë (Zvicër) në lidhje me ekspertizën e kërkuar për rastin e vdekjes së Astrit Deharit.

Ministri Abelard Tahiri iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Drita Millaku i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, në lidhje me rikthimin e shtetësisë së Kosovë për shqiptarët e shpërngulur në Turqi.

Ministri Bejtush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Nënkryetarja e Kuvendit Aida Dërguti i parashtrroi pyetje ministrit të Financave, Bedri Hamza, nëse Kosova ka aplikuar me ndonjë projekt në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës.

Ministri Bedri Hamza iu përgjigj pyetjes së nënkryetares.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve të kësaj ministrie për rregullimin e stacioneve për autobusë përgjatë rrugëve magjistrale, si dhe për sinjalizim më të mirë të vendkalimeve për këmbësorë në vendet urbane.

Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve të kësaj ministrie për furnizim me barnat nga lista esenciale.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

3. Shqyrtimi i Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e propozimit të Presidentit për fshirjen e nenit 34, nën-paragrafët: 2.5.1; 2.5.2; 2.5.3 dhe 2.5.4 të Ligjit për shoqëritë tregtare.

Zëvendëskryetari i parë i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, Dardan Sejdiu, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime të komisionit.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për raportin e Komisionit FunkSIONAL.

Lidhur me raportin e Komisionit FunkSIONAL diskutuan deputetët: Mimoza Kusari-Lila, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Fatmire Kollçaku, në emër të GP të LVV-së; Visar Ymeri, në emër të GP të PSD-së; Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së; Albulena Balaj-Halimaj, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate; Armend Zemaj, Sami Kurteshi, Milaim Zeka dhe nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi i sqaroi procedurat e veçanta, të parapara në nenin 80 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 61 (5) të Rregullores së Kuvendit për vendimmarrjen nga Kuvendi për ligjin e kthyer nga Presidenti, përkatësisht për rekomandimin e Komisionit FunkSIONAL në lidhje me vërejtjet e Presidentit.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim rekomandimin e propozuar në Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në lidhje me Vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 28,
Kundër----- 32,
Abstenime----- 7.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Nuk miratohet rekomandimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal për Vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. 461/1, datë: 04.4.2018 për kthimin e Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.
2. Ligji nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare, mbetet ashtu siç është miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 15 mars 2018 dhe konsiderohet i shpallur.
3. Ligji nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare i dërgohet për publikim Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacione dhe Ndërmarrësi e ka shqyrtuar Projektligjin për Statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, diskutuan deputetët: Ismaj Kurteshi, në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacione dhe Ndërmarrësi; Valentina Bunjaku-Rexhepi, në emër të GP të LDK-së; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Adem Mikullovc, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së; Albulena Balaj-Halimaj, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate; Mufera Srbica-Shinik, në emër të GP “6+”; Ismet Beqiri, Luljeta Veselaj-Gutaj, Arbërie Nagavci, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka, Naser Osmani, Haxhi Avdyli, Bekim Haxhiu, Sami Kurteshi, Muharrem Nitaj, Armend Zemaj, Mexhide Mjaku-Topalli, Blerta Deliu-Kodra, Arban Abrashi, Zenun Pajaziti dhe Vjosa Osmani-Sadriu, si dhe Ministri i Financave, Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për----- 71,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 2.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

* * *

Më pas, deputeti Naser Osmani, në emër të GP të LDK-së, propozoi që të hiqen nga rendi i ditës i seancës plenare tri pika: 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale; 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe 7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për tatimin në vlerën e shtuar, projektligje të propozuar nga GP i LDK-së.

Lidhur me propozimin e lartcekur diskutoi Ministri i Financave, Bedri Hamza, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e konstatoi heqjen nga rendi i ditës i Seancës plenare, tre pika: 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale; 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe 7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për tatimin në vlerën e shtuar.

* * *

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Nait Hasani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Lidhur me Projektligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën, diskutoi deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, diskutimi i të cilit është i dhënë në transkript.

Në këtë projektligj ishin propozuara gjithsej 12 amendamente.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

Kuvendi nuk e miratoi amendamentin 3.

Më pas, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 66,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 38 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim përnjëherë 38 amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi amendamentet prej 1 deri 38.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 74,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit.

10. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2018-2022

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Integritim Evropian e ka shqyrtuar Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2018-2022 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL për IntegRime Evropiane, Blerta Deliu-Kodra, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Lidhur me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2018-2022, diskutuan deputetët: Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Fatmire Kollçaku, në emër të GP të LVV-së; Shqipe Pantina, në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Milaim Zeka, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate; Avdullah Hoti, nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sami Kurteshi, Fatmir Xhelili, Vjosa Osmani-Sadriu dhe Blerta Deliu-Kodra, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij programi shtyhet.

Votimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2018-2022 është bërë më 30 maj 2018.

Rezultati i votimit, ishte si në vijim:

Për ----- 71,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 4.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Programi Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2018-2022.

11. Shqyrtimi i Strategjisë shtetërore të ujërave në Kosovë, 2017-2036

Kryetari i njoftoi deputet se Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e ka shqyrtuar Strategjinë shtetërore të ujërave në Kosovë 2017-2036 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin saj.

Ministri Skender Reçica, në emër të Qeverisë e paraqiti dhe e arsyetoi këtë strategji.

Lidhur me Strategjinë shtetërore të ujërave në Kosovë 2017-2036, diskutuan deputetët: Salih Salihu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe në emër të GP të PSD-së; Lutfi Zharku, në emër të GP të LDK-së; Ganimete Musliu, në emër të GP të PDK-së; Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate dhe Mimoza Kusari Lila, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të kësaj Strategjie shtyhet.

Votimi i Strategjisë shtetërore të ujërave në Kosovë 2017-2036 është bërë më 30 maj 2018.

Rezultati i votimit, ishte si në vijim:

Për ----- 66,
Kundër ----- 5,
Abstenime ----- 3.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Strategjia shtetërore e ujërave në Kosovë 2017-2036.

12. Shqyrtimi i Planit të veprimit për biodiversitetin, 2016-2020

Kryetari i njoftoi deputet se Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e ka shqyrtuar Planin e veprimit për biodiversitetin, 2016-2020 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin tij.

Ministri Skender Reçica, në emër të Qeverisë e paraqiti dhe e arsyetoi këtë Plan të veprimit.

Lidhur me Planin e veprimit për biodiversitetin 2016-2020 diskutuan deputetët: Salih Salihu, në emër të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe në emër të GP të PSD-së; Lutfi Zharku, në emër të GP të LDK-së; Ganimete Musliu, në emër të GP të PDK-së; Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së dhe Enver Hoti, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij Plani të veprimit shtyhet.

Votimi i Planit të veprimit për biodiversitetin 2016-2020 është bërë më 30 maj 2018.

Rezultati i votimit, ishte si në vijim:

Për ----- 71,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 5.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Plani i veprimt për biodiversitetin, 2016-2020.

13. Shqyrtimi i raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2017

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratim e tij.

Lidhur me Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2017, diskutuan deputetët: Dardan Sejdiu, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Arbërie Nagavci, në emër të GP të LVV-së; Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij raporti shtyhet.

Votimi i raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2017 është bërë më 30 maj 2018.

Rezultati i votimit, ishte si në vijim:

Për ----- 47,
Kundër----- 24,
Abstenime ----- 8.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2017, me rekomandimet e Komisionit Funkcional.

Pastaj, kryetari i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 19:35 minuta.

* * *

E mërkurë, më 30 maj 2018

Vazhdimi i seancës plenare

Seancën plenare e drejtoi kryetari, z. Veseli.

Në fillim, deputeti Sami Kurteshi propozoi që seanca të vazhdohet me diskutimet e disa pikave për të cilat vetëm është përfunduar diskutimi i tyre më 17 maj 2018, diskutimi i të cilit është i dhënë në transkript.

Lidhur me propozimin e lartcekur të deputetit Sami Kurteshi, diskutuan: Kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, Avdullah Hoti, Dardan Sejdiu, Glauk Konjufca, Bilall Sherifi, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Duda Balje, Faton Topalli, Teuta Haxhiu, Muharrem Nitaj dhe nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari deklaroi se për pikat e rendit të ditës për të cilat ngriti shqetësimet e tij deputeti Sami Kurteshi, diskutimet kanë përfunduar më 17 maj 2018, ndërsa për çështjen e pikave të papërfunduara nga seancat tjera plenare, deputetët do të njoftohen.

Pastaj, seanca plenare i vazhdoi punimet me pikat e rendit të ditës si në vijim.

14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratim e tij.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017.

Lidhur me raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, diskutuan deputetët: Duda Balje, në emër të Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione; Lumir Abdixhiku në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Lirije Kajtazi, në emër të GP të LDK-së; Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Frashër Krasniqi, në emër të GP të PSD-së; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së dhe Zafir Berisha, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari deklaroi se raportimi i Avokati i Popullit, z. Hilmi Jashari, diskutimet e deputetëve dhe votimi i Raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, do të vazhdojnë një ditë tjetër.

15. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë për ndihmë juridike falas për vitin 2017 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratim e tij.

Lidhur me raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017 diskutuan deputetët: Hajdar Beqa, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit; Korab Sejdiu, në emër të GP të LDK-së; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së dhe Frashër Krasniqi, në emër të GP të PSD-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim raportin vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 56,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 7.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017.

16. Propozimi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët me propozimin e GP të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Me propozimin e GP të AAK-së, Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 06-V-006

I. Vendimi nr. 06-V-006, datë 3 tetor 2017, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1. Deputetja Donika Kadaj-Bujupi nga Grupi Parlamentar i AAK-së emërohet anëtare në Komisionin Parlamentar për Integritet Evropian, në vend të deputetit Ahmet Isufi.

2. Deputeti Ahmet Isufi nga Grupi Parlamentar i AAK-së emërohet anëtar në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetit Muharrem Nitaj.

17. Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Komisionit të Pavarur të Medieve, i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve dhe Kuvendit ia ka rekomanduar emërimin e dy (2) anëtarëve nga katër (4) kandidatët e propozuar.

Rasim Selmanaj, kryetar i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Komisionit të Pavarur të Medieve, e paraqiti dhe arsyetoi raportin dhe rekomandimin e Komisionit.

Pastaj, kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues, për të zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e zgjodhi Komisionin votues në këtë përbërje:

Fidan Rekaliu, GP-LDK,
Andin Hoti, GP-PDK,
Salih Zyba, GP-LVV,
Driton Çausi, GP-PSD,
Rasim Selmanaj, GP-AAK,
Adem Hoxha, GP-Lista Serbe dhe
Bahrim Shabani, GP- "6+".

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit votues që të fillojnë me procedurat e votimit të fshehtë dhe i filloi procedura e votimit me deputetët sipas radhës.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve e paraqiti deputeti Andin Hoti.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim kishin marrë pjesë 83 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 4 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin, si në vijim:

1. Muja Ferati ----- 46 vota,
2. Jeton Mehmeti ---- 35 vota,
3. Anita Muriqi ----- 38 vota,
4. Adem Lushaj ----- 21 vota.

Kryetari konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit, vetëm kandidati Muja Ferati i mori votat e nevojshme për zgjedhje anëtar i Komisionit të Pavarur të Medieve, ndërsa për pozitën tjetër do të zhvillohet raundi i dytë i votimit me dy kandidatët që kanë fituar më së shumti vota, Anita Muriqi dhe Jeton Mehmeti.

Në vazhdim, kryetari i ftoi deputetët për votim në raundin e dytë.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit në raundin e dytë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit e paraqiti deputeti Andin Hoti.

Rezultati i votimit ishte:

- Në votim kishin marrë pjesë 88 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 4 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin si në vijim:

1. Anita Muriqi ----- 51 vota,
2. Jeton Mehmeti -----33 vota.

Kryetari konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit të raundit të dytë, kandidatja Anita Muriqi i mori votat e nevojshme për zgjedhje anëtare e Komisionit të Pavarur të Mediave.

18. Propozim-Rezoluta për heqjen e romingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë

Kryetari i njoftoi deputetët se deputeti Dardan Molliqaj, i mbështetur edhe nga 11 deputetë tjerë, kanë propozuar Rezolutë për heqjen e romingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Deputeti Dardan Molliqaj e paraqiti dhe e arsyetoi Propozim-Rezolutën.

Lidhur me Propozim-Rezolutën për heqjen e romingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, diskutuan deputetët: Mimoza Kusari-Lila, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së; Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së; Milaim Zeka, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, Islam Pacolli, Armend Zemaj dhe Hajdar Beqa, si dhe Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, deputeti Dardan Molliqaj dha shpjegime shtesë për Propozim-Rezolutën dhe e lexoi tekstin e propozuar.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Propozim-Rezolutën për heqjen e romingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 69,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kuvendi miratoi këtë:

REZOLUTË

Për heqjen e roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë

1. Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të integritit ekonomik me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë të nisë procedurat për arritjen e marrëveshjes për heqjen e tarifave të roamingut në telefoninë mobile ndërmjet qytetarëve të dy vendeve respektive.
2. Të themelohet Komisioni i Përbashkët Qeveri-Kuvend për fillimin e bisedimeve për eliminimin total të tarifave të roamingut në Kosovë dhe Shqipëri. Anëtarët nga Kuvendi pjesë e këtij komisioni janë përfaqësuesit e secilit grup parlamentar në legjislaturën aktuale.
3. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Kosovës dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Shqipërisë të përkujdeset për implementimin e kësaj marrëveshje.
4. Të thellohet bashkëpunim në fushën e komunikimeve elektronike, me theks të posaçëm në shkëmbimin e trafikut të internetit drejtpërdrejtë ndërmjet njejeve shkëmbyese të internetit (Internet Exchange Point -IXP) të dy vendeve.
5. Komisioni i përbashkët të raportojë në Kuvend për arritjen e marrëveshjes dhe ecurinë e eliminimit të tarifave jo më larg se dy muaj nga miratimi i kësaj rezolute

19. Propozim-Rezoluta për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje/daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë

Kryetari i njoftoi deputetët se deputeti Dardan Molliqaj, i mbështetur edhe nga 11 deputetë tjerë, kanë propozuar Rezolutë për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje/daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë.

Deputeti Dardan Molliqaj e paraqiti dhe e arsyetoi Propozim-Rezolutën.

Lidhur me Propozim-Rezolutën për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje/daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë, diskutuan deputetët: Hykmete Bajrami, në emër të GP të LDK-së; Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së; Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së; Faton Topalli, në emër të GP të PSD-së; Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, Armend Zemaj, Arben Gashi, Teuta Haxhiu, Milaim Zeka, Blerta Deliu-Kodra, nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, deputeti Dardan Molliqaj dha shpjegime shtesë për Propozim-Rezolutën dhe kërkoi nga grupet parlamentare që të harmonizojnë Propozim-Rezolutën.

Më pas, deputeti Dardan Molliqaj, e paraqiti Propozim-Rezolutën e harmonizuar me grupet tjera parlamentare.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Propozim-Rezolutën për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje/daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 73,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi miratoi këtë:

REZOLUTË

Për heqjen e tërësishme të kontrollit për hyrje/daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në pikat kufitare: Vërmicë, Qafë Prush, dhe Qafë Morinë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që të nisë procedurat e domosdoshme kushtetuese dhe ligjore për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare për hapjen e kufijve për qarkullimin e lirë të njerëzve të cilët janë shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Të gjitha procedurat e nevojshme në lidhje me këtë çështje të nisin menjëherë me miratimin e kësaj rezolute.

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet marrëveshje bilaterale e cila e heq detyrimin për qytetarët e të dy shteteve për të udhëtuar me letërnjoftim dhe pasaporta, duke lejuar që shtetasit e të dy shteteve respektive të udhëtojnë drejtpërdrejt dhe pa u penguar nëpërmjet

pikave të kontrollit kufitar, duke përfshirë mos kontrollin e automjeteve me shpejtësi të reduktuar.

3. Realizimi i kësaj rezolute do të bëhet duke marrë në konsideratë praktikat më të mira evropiane dhe direktivat e Bashkimit Evropian për këtë çështje.

20. Debat parlamentar në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i LVV-së ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës.

Pastaj, kryesuesi e ftoi deputetin Glauk Konjufca ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Deputeti Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të LVV-së, si parashtrues i kërkesës, e paraqiti dhe e arsyeoi në tërësi çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar. Diskutimi i deputetit Glauk Konjufca është i dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin lidhur me çështjen e ngritur për debat parlamentar.

Lidhur me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës diskutuan: Kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli dhe deputetët: Naser Rugova, në emër të GP të LDK-së; Xhevahire Izmaqi, në emër të GP të PDK-së; Fatmire Kollçaku, në emër të GP të LVV-së; Faton Topalli, në emër të GP të PSD-së; Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, Lumir Abdixhiku, Bekim Haxhiu, Albin Kurti, Frashër Krasniqi, Shkumbin Demaliaj, Milaim Zeka, Armend Zemaj, Hajdar Beqa, Arbër Rexhaj, Teuta Haxhiu, Bilall Sherifi, Imet Rrahmani, Mërgim Lushtaku, Sami Kurteshi, Korab Sejdiu, Luljeta Veseli-Gutaj, Drita Millaku, Sali Zyba, Muharrem Nitaj, Hykmete Bajrami, Ismajl Kurteshi dhe Lutfi Zharku, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje për të proceduar votimin e Projekt-Rezolutës së propozuar nga GP i LVV-së.

Kryetari në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare, i ndërpreu punimet e seancës plenare në ora 20:00, ndërsa për vazhdimin e saj do të vendosë Kryesia e Kuvendit.

Votimi i Propozim-Rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës është bërë më 4 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 67,
Kundër----- 6,
Abstenime----- 5.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Të rishikohet dhe të paraqitet për ndryshim në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Ligji i Punës dhe paketa ligjore që garanton të sigurinë në punë, të drejtat e punëmarrësit dhe organizimin sindikal në Republikën e Kosovës, duke përfshirë në plotëni kërkesat e sindikatave të Kosovës dhe të sanksionohet zbatimi i Kontratës Kolektive.
2. Të rishikohet dhe të ndryshohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës vendimi për pagën minimale.
3. Të iniciohet ndryshimi dhe amendamenti i legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës për të favorizuar punësimin e grave dhe vajzave.
4. Të përshpejtohet puna e Komisionit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale në procedimin e ligjit për biznesin social.
5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale t'i paraqesë raportin e detajuar mbi gjendjen e zbatimit të të drejtave të punës dhe të projektit që ka iniciuar për subvencionim e pagës dhe atë për punësimin e një anëtari të familjes në familjet pa asnjë të punësuar.
6. Zbatimi pa vonesa i Marrëveshjes me Republikën e Shqipërisë për të hequr lejen e punës për të punësuarit nga ky vend në përputhje këtë marrëveshje që aktualisht është në zbatim në Republikën e Shqipërisë.

* * *

E premte, më 1 qershor 2018

Vazhdimi i seancës plenare

Kryetari procedoi me pikat e papërfunduara më 17 dhe 30 maj 2018, si në vijim.

14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017

Kryetari i njoftoi deputetët se në seancën plenare të mbajtur më 17 maj 2018 kanë përfunduar diskutimet e përfaqësueseve të grupeve parlamentare dhe paraqitjet e

rekomandimeve të Komisionit Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Pastaj, ai e ftoi Avokatin e Popullit, që para deputetëve ta paraqesë raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017.

Avokati i Popullit, z. Hilmi Jashari, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, fjalimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017.

Lidhur me raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, diskutuan deputetët: Sami Kurteshi, Time Kadrijaj, Duda Balje, Luljeta Veselaj-Gutaj, Fatmire Kollçaku, Teuta Haxhiu, Blerta Deliu Kodra, Albulena Haxhiu, Muharrem Nitaj, Xhevahire Izmaku, Bekim Haxhiu dhe Adem Mikullovc, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Avokati i Popullit, z. Hilmi Jashari iu përgjigje pyetjeve të deputetëve të parashtruara gjatë diskutimeve.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje për të proceduar votimin e raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, por i njëjti do të procedohet një ditë tjetër gjatë vazhdimit të seancës plenare.

Votimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017 është bërë më 4 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 80,
Kundër----- 7,
Abstenime----- 3.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017.

* * *

E hënë, më 4 qershor 2018
Vazhdimi i seancës plenare

Kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli i njoftoi deputetët për vazhdimin e seancës plenare me pikat e papërfunduara nga seanca e filluar më 17 maj 2018 dhe të seancës tjetër të mbajtur më 17, 18, 20 e 26 prill dhe më 31 maj e 1 qershor 2018.

Pas njoftimit nga kryetari i Kuvendit lidhur me vazhdimin e seancës plenare të filluar më 17 maj 2018, për fjalë u paraqit kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti i cili paraqiti mospajtim në lidhje me vazhdimin e seancave, pasi që për datë 4 qershor 2018 ishte e paraparë vetëm Seancë e re plenare. Diskutimi i plotë i z. Hoti është i dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e ngritur nga kryetari i GP të LDK-së për vazhdimin e seancave me pikat e papërfunduara, diskutuan: Kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli; nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala; Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së; Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Dardan Molliqaj, në emër të GP të PSD-së; Sasha Milosavljeviq, në emër të GP të Listës serbe; Albert Kinolli, në emër të GP “6+” dhe Ahmet Isufi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim mocionin për vazhdimin e seancës plenare të filluar më 17 maj 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 46,
Kundër----- 32,
Abstenime----- 3.

Kuvendi vendosi për vazhdimin e seancës plenare me pikat e papërfunduara nga Seanca plenare e filluar më 17 maj 2018.

Pastaj, kryetari procedoi me pikat e papërfunduara nga seanca plenare e mbajtur më 17 dhe 30 maj 2018, si në vijim:

21. Debat parlamentar në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre, sipas kërkesë së deputetit Visar Ymeri, mbështetur edhe nga 11 deputetë

Kryetari i njoftoi deputetët se deputeti Visar Ymeri i mbështetur edhe nga 11 deputetë, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre.

Pastaj, kryesuesi e ftoi deputetin Visar Ymeri ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Deputeti Visar Ymeri, në emër të propozuesit, e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar. Diskutimi i deputetit Visar Ymeri është i dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin lidhur me çështjen e ngritur për debat parlamentar.

Lidhur me zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre, diskutuan deputetët: Lutfi Zharku, në emër të GP të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Arbër Rexhaj, në emër të GP të LVV-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, Naser Rugova, Bekim Haxhiu, Muharrem Nitaj dhe Milaim Zeka, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, deputeti Visar Ymeri dha shpjegime shtesë nga debati dhe kërkoi nga deputetët që ta përkrahin Propozim-Rezolutën e propozuar për çështjen e debatuar.

Pastaj, kryetari konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje për të proceduar votimin e Projekt-Rezolutës së propozuar nga deputeti Visar Ymeri.

Votimi i Propozim-Rezolutës nga debati parlamentar lidhur me zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre është bërë më 5 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 67,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës t'i nisë menjëherë procedurat e nevojshme ligjore për arritjen e marrëveshjes ndërkombëtare për unifikimin e doganave me Republikën e Shqipërisë.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet marrëveshjen bilaterale, e cila i unifikon doganat ndërmjet dy shteteve respektive.

22. Debat parlamentar në lidhje me Kartonin e Gjellbër, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se deputeti Faton Topalli i mbështetur edhe nga 11 deputetë, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar në lidhje me Kartonin e Gjellbër.

Ai e ftoi deputetin Faton Topalli ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Deputeti Faton Topalli, në emër të propozuesit, e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar. Diskutimi i deputetit Topalli është i dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin parlamentar.

Lidhur me Kartonin e Gjellbër, diskutuan deputetët: Lumir Abdixhiku, në emër të GP të LDK-së; Mërgim Lushtaku, në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Salih Salihu, në emër të GP të PSD-së; Blerim Kuç, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, Naser Osmani, Korab Sejdiu, Zenun Pajaziti, Adem Mikullovc, Muharrem Nitaj, Milaim Zeka, Islam Pacolli, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Armend Zemaj, Safete Hadërgjonaj, Daut Haradinaj dhe nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, deputeti Faton Topalli dha shpjegime shtesë nga debati dhe kërkoi nga deputetët që t'i përkrahin rekomandimet e propozuara për çështjen e debatuar.

Pastaj, kryetari konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje për të proceduar votimin e rekomandimeve të propozuar nga deputeti Faton Topalli.

Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me Kartonin e Gjellbër, të harmonizuara me grupet tjera parlamentare është bërë më 5 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 78,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 1.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto:

REKOMANDIME

1. Kuvendi i Kosovës mbështet Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision funksional, që t'i koordinojë hapat mbikëqyrës dhe organizativë të institucioneve kompetente në vend, në radhë të parë të Bankës Qendrore të Kosovës, Byrosë Kosovare të

Sigurimeve, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave, me qëllim të zgjidhjes së shpejtë të çështjes në fjalë - duke mos përjashtuar zgjidhjet alternative deri në anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjellbër.

2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe grupet punuese që derivojnë nga ai, ka për detyrë që t'i koordinojë dhe ndajë detyrat për institucionet relevante në vend; si dhe t'i përcaktojë veprimet konkrete brenda detyrave për secilin aktor.

3. BQK-ja në rolin e saj mbikëqyrës mbi Byronë e Sigurimeve të Kosovës të kërkojë nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës që deri më 30 qershor 2018 ta analizojë lartësinë e primit të Policës Kufitare për ta shikuar mundësinë e uljes së çmimit të saj prej datës 1 korrik 2018.

4. Brenda një muaji, Ministria e Punëve të Brendshme obligohet të dalë me plan veprues për reduktimin e automjeteve të peregjistruara që qarkullojnë brenda Republikës së Kosovës.

5. Brenda periudhës tremujore, Ministria e Punëve të Brendshme ta reduktojë numrin e automjeteve të peregjistruara nga 20% në 5%.

6. Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe grupet punuese që dalin nga ai, më së largu deri më 1 dhjetor 2018 t'ia paraqesin Kuvendit raportin për ecurinë e angazhimeve të secilit institucion. Nëse deri atëherë nuk arrihet zgjidhje e përkohshme apo e përhershme për Kartonin e Gjellbër, t'ia paraqesë Kuvendit koston financiare të njohjes së njëanshme të Kartonit të Gjellbër - si dhe rekomandimin për këtë njohje.

23. Debat parlamentar në lidhje me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare, sipas kërkesës së deputetit Fidan Rekaliu, mbështetur edhe nga 5 deputetë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se deputeti Fidan Rekaliu i mbështetur edhe nga 5 deputetë, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar në lidhje me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare.

Ai e ftoi deputetin Fidan Rekaliu ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Deputeti Fidan Rekaliu, në emër të propozuesit, e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar, si dhe propozoi që në fund të debatit të miratohet një Rezolutë në lidhje me çështjen e cila do të debatohet. Diskutimi i deputetit Fidan Rekaliu është i dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi e hapi debatin parlamentar.

Lidhur me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare, diskutuan deputetët: Andin Hoti, në emër të GP të PDK-së; Adem Mikullovc, në emër të GP të LVV-së; Frashër Krasniqi, në emër të GP të PSD-së; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, Korab Sejdiu, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Fitore Pacolli-Dalipi,

Salih Salihu, Milaim Zeka, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Xhevahire Izmaçu, Arbër Rexhaj, Muharrem Nitaj, Bilall Sherifi, Emilija Rexhepi, Nait Hasani, Naser Rugova, Bekim Haxhiu, Drita Millaku, Fisnik Ismaili, Blerim Kuçi, Islam Pacolli, Armend Zemaj, Mërgim Lushtaku, Fatmire Kollçaku, Ganimete Musliu, Saranda Bogujevci, Arbërie Nagavci, Xhelal Sveçla, Ismajl Kurteshi, dhe Nezir Çoçaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje për të proceduar votimin e Projekt-Rezolutës së propozuar nga deputeti Fidan Rekalii.

Pastaj, kryetari në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare, vendosi që të nesërmen, më 5 qershor 2018, para fillimit të seancës së re plenare të caktuar për 5 qershor 2018, të procedohet votimi i Projekt-rezolutës së propozuar.

Kryetari i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 19:05 minuta.

* * *

E martë, më 5 qershor 2018

Vazhdimi i seancës plenare

Kryetari procedoi me votimin e Propozim-Rezolutës nga debati parlamentar lidhur me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare, të propozuar nga deputeti Fidan Rekalii, të harmonizuara me grupet tjera parlamentare.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 73,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Të miratohet sa më shpejtë Strategjia për Rini dhe t'i sigurohet e gjithë mbështetja e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Të realizohet në afatin sa më të shkurtër plotësim-ndryshimi i Ligjit nr. 03/L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, brenda vitit 2018.
3. Obligohet Qeveria e Kosovës që ta zbatojë në përpikëri Planin e Veprimit: Rritja e punësimit të të rinjve, 2018-2020.

4. Qeveria e Kosovës t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për krijimin e kushteve të favorshme për punësim për kadrot cilësore në Republikën e Kosovës, si dhe për kthimin e trurit të mërgatës në Kosovë brenda vitit 2018.

5. Obligohet Qeveria e Kosovës që të krijojë lehtësira për të rinjtë ndërmarrës.

6. Qeveria e Kosovës ta krijojë një program të veçantë për kategorinë e të rinjve që nuk janë në punë, në shkollë apo në trajnim brenda vitit 2018.

7. Të krijohet programi nga Qeveria e Kosovës për mbështetje financiare për punën praktike të të posadiplomuarve në institucionet publike dhe private, të njihet puna vullnetare si përvojë pune dhe të fillojë të zbatohet nga institucionet përgjegjëse brenda vitit 2018.

8. MASHT-i të fillojë me reforma të planprogrameve arsimore për përshtatjen e tyre me nevojat e tregut të punës për të rinjtë, si dhe stimulimin e drejtimeve deficitare me bursa shtesë, brenda vitit 2018.

9. Qeveria të krijojë mekanizma që t'i luftojë fuqishëm dukuritë negative të të rinjve në Kosovë, siç janë droga, prostitucioni, dhuna në shkolla, alkooli etj. dhe të krijojë mekanizma në rehabilitimin e tyre brenda vitit 2018.

10. MPJ, MIE, si dhe ministritë tjera të linjës t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që të rinjtë e Kosovës të jenë pjesë dhe përfituese të të gjitha programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar, në veçanti programet e BE-së.

11. Në të gjitha institucione publike të krijohen kushtet për pavarësimin e të rinjve me aftësi të kufizuara.

12. Ministritë e linjave të krijojnë lehtësime në fushën e shitjes së shërbimeve (outsourcing) për të rinjtë ndërmarrës.

13. Shqiptarët nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja të kenë të drejtën e studimeve në universiteteve publike me kushte të barabarta me studentët kosovarë.

14. Të bëhet një hulumtim nga Qeveria për ndërtimin e një programi për mbështetjen e të rinjve për krijimin e familjeve të reja, si dhe të ndahet një shumë e mjaftueshme buxhetore për këtë kategori shumë të rëndësishme të shtetit brenda vitit 2018.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare më 5 qershor 2018, në orën 12:00.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale